


Metodat analitike

- ❖ Hyrje në këtë grup metodash
- ❖ Metoda e fjalëve
- ❖ Metoda e grupeve të fjalëve
- ❖ Metoda e fjalive

Hyrje në këtë grup metodash

Metoda analitike nisët nga e tëra (teksti, fjalia, fjala) për të arritur tek e veçanta (tek tingulli, përkatësisht tek shkronja). Përparësia e metodës analitike qëndron në atë, se ajo e zhvillon të menduarit dhe nxit të kuptuarit e asaj që lexohet.

Metoda analitike nënkupton forma të organizimit të punës, ku në fillim merren në shqyrtim njësitë gjuhësore të përbëra, si fjala, togfjalëshi, fraza etj., duke vazhduar procedurat me analizat e tyre në fjalë, rrokje, tinguj e në fund e vë theksin në të kuptuarit e tërësisë që lexohet. Në mënyrë skematike mund ta përmbledhim këtë grup metodash nga pikëpamja e ecurisë metodike si më poshtë:



Kjo metodë karakterizohet nga fakti që në fillim i njohin nxënësit me njësitë gjuhësore kumtuese:

- ❖ fjala
- ❖ togfjalëshi
- ❖ fjalia

Pastaj ato zbërthehen në elementet e tyre përbërese. Metoda analitike mbështetet në të dhënat psikologjike të fëmijës, sepse ata i njohin sendet dhe i kuptojnë idetë në

fillim në tërësi, ndonëse në mënyrë pak a shumë të paqartë, kurse detajet arrijnë t'i shquajnë më vonë dhe në mënyrë progresive.

Metoda e fjalëve. Fjala mbart një kuptim dhe mësohet sipas parimit “**shih dhe thuaj**”. Për të lehtësuar mbajtjen mend të fjalës, ajo shoqërohet me figura “etiketa” p.sh.



Bëhet përsëritja e vazhdueshme e fjalës që nxënësit ta mbajnë mend lehtësisht sapo ta shohin, më pas kalojnë në analizën e elementeve të saj, rrokje-shkronja.

lule

Nga fjala vëmendje përqendrohet tek rrokjet dhe shkronjat, duke i dalluar edhe fjalët e tjera që i përmbajnë këto elemente.

lu - **le**

Jepen fjalë dyrrokëshe e njërrrokëshe në mënyrë që të përceptohet sa më mire koncepti i rrokjes.



l, u, l, e,

Kjo metodë lejon të përvetësohen të gjitha elementet fonetike. Kjo metodë lejon të përvetësohen të gjitha elementet fonetike. Ato i ndihmojnë nxënësit që të lexojnë fjalët e reja pa ndihmën e mësuesit. Përdorimi i kësaj metode mbështet faktin se fjalët janë njësi bazë për të menduarit dhe kujtesën. Shumica e njerëzve i njohin objektet globalisht, para se të dallojnë elementet e tyre. Le ta konkretizojmë me rastin e mëposhtëm. Mësuesja punon me figurë duke i shtyrë nxënësit për të identifikuar veprimin (**lyen**) dhe objektin mbi të cilin kryhet ky veprim (**pema**). Teksti i sugjeron fjalët e ndara në rrokje. Janë fjalë kryesit dy rrokëshe (**la-u, le-u, pe-më, le-u**) por edhe njërrrokëshe (**kap, pak**).



Që kjo metodë të jetë e sukseshme duhet patjetër të jepen edhe detyra që fëmijët të ushtrohen me këtë metodë. Jepen fjalë që të ndahen në njësitë përbërëse. Sugjerohet që fjalët të jenë pjesë e leksikut të fëmijëve, pra fëmijët t'i njohin dhe t'ia dinë kuptimin dhe së dyti, të jenë fjalë të cilat të kenë një rritje progresive sa i takon numrit të rrokjeve. Po japim një shembull:

Ndaj fjalët në rrokje e shkronja (6 pikë)



Metoda e grupeve të fjalëve

Kjo metodë mbështet faktin se një pjesë e fjalëve ose një grup fjalësh ka më shumë kuptim dhe paraqet më shumë interes sesa një fjalë e vetme. Pra, tani përfshihet jo një fjalë, por një grup fjalësh bazë për leximin që duhen mbajtur mend. Po e kontretizojmë si më poshtë:



lule e bukur

lule **bukur**

lu - **le** **e** - **bu** - **kur**

l, **u**; **l**, **e** **e**; **b**, **u**; **k**, **u**, **r**

Ecuria metodike: Mësuesi shkruan një pjesë fjalie. Nxënësit e përsërisin atë disa herë, e krahasojnë me ato që kanë mësuar më parë, derisa arrijnë ta njohin. Në brendësi të saj fillojnë të dallojnë ato fjalë që njohin nga fjalët e reja. Fjalët e reja fillojnë t'i deshifrojnë në mënyrë intuitive në elemente përbërëse.

Metoda e fjalive


Janë metoda ku fjalia është njësi e natyrshme gjuhësore, sepse kumton ide të plota, që janë njësi e të menduarit dhe e të lexuarit, duke mbajtur parasysh kuptimin e saj global. Pra kemi si pikënisje fjalinë, ku dallohen disa grupe fjalësh të rëndësishme dhe fjalë të tjera të caktuara në grup.



Më pas tërhiqet vëmendja te elementet përbërese të fjalëve (rrokja, e më pas shkronja). Këto elemente futen në përdorim për të lexuar fjalë të reja, pa u ndihmuar. Kështu arrihet të kuptohen tekstet p.sh.



Metodistë sugjerojnë që për ilustrimin e kësaj metode të mos merren fjali nga fragmentet letrare nga librat, por fjali të shkruara, të thjeshta, të kuptueshme, të përshtatshme për këtë mosë shkollore dhe me një strukturë fonetike dhe grafike të përshtatshme. Për të njohur kufijtë e fjalës dhe për të mësuar konceptin e fjalisë, nxënësve mund t'u jepet edhe një ushtrim i tillë ku kërkohet që të veçohen fjalët dhe të shkruhet fjalia:



Po e ilustrojmë me shembull ecurinë metodike të cilën e përshkruam më lart teorikisht. Le të marrin një fjali të thjeshtë:

Blerta udhëton me tren.



Blerta udhëton

Udhëton me tren

Nga fjalia mësuesi kalon tek një pjesë e fjalisë. Duhet ndarë fjalia në etiketa dhe punohet me grupet e fjalëve. Më tej grupet (togfjalëshat) ndahen fjalë.

Blerta, udhëton, me, tren.

Në hapin tjetër secila prej fjalëve ndahet në rrokje:

Bler-ta; u-dhë-ton; me; tren

Këto janë disa rekomandime për përdorimin e metodave analitike.

Do të shfaqen orë model të orëve të mësimi për lexim-shkrimin fillestar në linqet:

https://www.youtube.com/watch?v=-QgkztXStEk&ab_channel=Kallxo.com

https://www.youtube.com/watch?v=5ng_mL3AAiQ&ab_channel=MinistriaeArsimit%2CSportitdheRinis%C3%AB

Do të tregohen modele të orëve të zhvilluara online të studentëve të kaluar të vitit IV.